



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.135/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma për Kosovën dhe Lista Ideal, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve KQZ-KKZ, me seli në Gjakovë për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 24.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë e palejuar ankesa Anr.135/2025 e datës 23.01.2025, parashtruar nga Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma për Kosovën dhe Lista Ideal, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve KQZ-KKZ, me seli në Gjakovë për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datën 23.01.2025 subjekti politik Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma për Kosovën dhe Lista Ideal, ka paraqitur ankesë në PZAP, me të cilin ka theksuar se me datë 22.01.2025, brenda ambienteve të objektit komunal në Gjakovë, Komisioni Komunal i Zgjedhjeve KKZ, ka mbajtur sesion informues me qytetarët. Në këtë sesion informues qytetarët janë informuar lidhur me informata të rëndësishme sa i përket aspektit të zgjedhjeve të përgjithshme duke përfshirë këtu, mënyrën se si do të votohet, subjekte politike që marrin pjesë në zgjedhje, si do duket fletëvotimi dhe aspekte të tjera me rëndësi. Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se nga ana e KKZ-së, Gjakovë është paraqitur një formë e fletëvotimit e cila është diskriminuese për shumicën e subjekteve politike, duke përfshirë edhe subjektin AAK, pasi që nuk paraqiten emrat e subjekteve politike dhe për më tepër nuk janë të paraqitur numrat e të gjitha subjekteve politike. Sipas parashtruesit të ankesës siç mund të vërehet edhe nga fotot e

bashkangjitura, fletëvotimi i cili i'u është paraqitur qytetarëve për tu informuar, lidhur me votimin nuk është i njëjti që është miratuar nga ana e KQZ-së, me datë 05.01.2025. Për më tepër nuk janë të paraqitura të gjithë numrat e subjekteve politike, respektivisht duke përjashtuar AAK-në e që paraqet një diskriminim për këtë subjekt politik, për më tepër është miratuar fletëvotimi zyrtar nga ana e KQZ-së, por i njëjti nuk është përdorur për informimin e qytetarëve, por në vend të njëjtit është përdorur një fletëvotim diskriminues. Tutje parashtuesi i ankesës ka theksuar se duke u bazuar në provat dhe dispozitat e nenit 68, par.1, nën par.1.2 dhe nenit 107, par.1 nën par.1.1 të LZP-së vërtetohet se KKZ-Gjakovë nuk ka arritur të siguroj përhapjen e informatave të nevojshme për administrimin e zgjedhjeve dhe KKZ-Gjakovë me rastin e paraqitjes së fletëvotimit në pikën informuese brenda ambientit të objektit të Komunës së Gjakovës, ka diskriminuar subjektin politik-AAK dhe nga të lartcekurat i ka propozuar PZAP-së, që pas arritjes së kushteve ligjore ta pranojë si të bazuar ankesën e subjektit politik AAK dhe në pajtim me ligjin e aplikueshëm ta shqiptojë sanksionin e merituar.

PZAP, me datë 23.01.2025 iu është drejtuar me kërkesë për përgjigje KQZ-së, lidhur me ankesën A.nr 135/02025 të parashtuar nga ankuesi Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma për Kosovën dhe Lista Ideal, me seli në Prishtinë. KQZ me datë 24.01.2025, ka parashtuar në PZAP, përgjigje në ankesë në të cilën theksohet se: Sipas nenit 107, paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është e obliguar të organizojë dhe sponsorizojnë fushata për edukimin e votuesve. Sesioni informues i mbajtur me datë 22.01.2025 në ambientet e Komunës së Gjakovës nga KKZ-Gjakovë ishte një aktivitet për të siguruar transparencë dhe informim të drejtë për qytetarët, në këtë aktivitet janë përdorur materiale informuese dhe ilustruese që shërbenin për edukimin e votuesve, duke mos përbërë material zyrtar apo përfundimtar për procesin e votimit.

Më tutje në përgjigje në ankesë është theksuar se përdorimi i materialeve edukative nuk kishte për qëllim dhe as për efekt diskriminimin e ndonjë subjekti politik, përfshirë AAK-në, mirëpo qëllimi i saj ishte vetëm edukativ dhe informues dhe pretendimi se subjekti politik AAK është përjashtuar apo diskriminuar nga materialet edukative nuk gjenë mbështetje në faktet dhe rrethanat e paraqitura. Duke analizuar të gjitha rrethanat faktike dhe juridike, vlerësojmë se veprimet e KKZ-së Gjakovë dhe materialet e përdorura gjatë sesionit informues ishin të ligjshme dhe në përputhje të plotë me Ligjin me Nr,08/L-228 dhe rregulloret e KQZ-së, KQZ ka konsideruar se ankesa është e pabazuar dhe ka kërkuar nga PZAP-ja që ankesa ta refuzojë si të pa bazuar.

Si provë në përgjigje në ankesë ka bashkangjitur kopjen e mostrës së formave zgjedhore të fletëvotimit të cilën e ka përdorur KKZ në Gjakovë në fushën informuese, si dhe vendimin nr.01/748/2024, të datës 29.04.2024.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës së parashtuar nga ankuesi, vëren se e njëjta është e pa lejuar.

Për të vlerësuar lejueshmërinë e paraqitjes së ankesës, paneli iu referuar Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, nenit 119 paragrafi 3, me të cilin është përcaktuar se “PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj.” Ndërsa kundër të cilave vendime të KQZ-së mund të ushtrohet ankesë është specifikuar me nenet, 27.6, 39.3, 41.5, 46, 51.4, 54.8, 69.7, 77.5, 80.3, 94.2, 98.3, 100.3, 102.1, 103.4 dhe 105.1, si dhe ato të cilat janë të përcaktuara në nenin 9, të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave.

Sipas vlerësimit të Panelit, nga interpretimi i dispozitave të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nuk përcaktohet me asnjë dispozite ligjore se mund të ankimohen vendimet e kësaj natyre të KQZ-së, përkatësisht, vendimi i KQZ-së për sesionin informues me qytetarët lidhur me aspektin e zgjedhjeve të përgjithshme në këtë kuptim, paneli vlerëson se rasti lëndor nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të ankimohen në PZAP, e rrjedhimisht nga kjo edhe ankesa është e palejueshme.

Prandaj, nga arsyet e paraqitura si më lart, në pajtim me nenin 13 paragrafi 3 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, si dhe nenit 119 paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën si të pa lejueshme.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A.nr.135/2025, datë 24.01.2025

Kryesuese e Panelit

Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.